VENDIM
Nr.41, datë 29.12.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Alfred Karamuço	Anëtar i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar i	“	“
Vjollca Meçaj	Anëtar e	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 29.04.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.23 Akti, që i përket:

KËRKUES:

1. ARBEN BËRBALLA, përfaqësuar nga avokat Vasil Plaku, me prokurë.

2. SOKOL KOÇIU, përfaqësuar nga avokat Arben Qeleshi, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORI I PËRGJITHSHËM, përfaqësuar nga Skënder Breca, me autorizim

OBJEKTI: Shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr.356, datë 14.04.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; nr.599, datë 15.11.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.327, datë 28.05.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkuesit Arben Bërballa e Sokol Koçiu kanë pretenduar se vendimet e mësipërme janë rezultat i një procesi të parregullt ligjor, gjë që sipas tyre, në mënyrë të përmbledhur, shfaqet në drejtimet e mëposhtme:

1. Janë shkelur ndalimet e parashikuara në nenin 29 të Kushtetutës dhe konkretisht:

- vepra penale e trafikut të narkotikëve, në kohën kur gjykatat deklarojnë krijimin e organizatës, nuk parashikohej në Kodin Penal;

- kërkuesit janë akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 284/a/2 të Kodit Penal, por pa e ndryshuar akuzën, janë deklaruar fajtorë e dënuar në bazë të nenit 284/a/1 të këtij Kodi duke u rënduar padrejtësisht pozitën;

- kërkuesi Sokol Koçiu është dënuar për veprën penale të falsifikimit me 9 vjet burgim, pra me një dënim që është më i lartë se maksimumi që parashikon neni 189 i Kodit Penal;

- gjykata e shkallës së parë ka zbatuar ligjin penal me analogji.

2. Është shkelur rregulli i parashikuar në nenin 34 të Kushtetutës për mosdënimin më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale.

3. Është shkelur parimi i gjykimit nga një gjykatë e krijuar me ligj, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe konkretisht:

- në gjykatën e shkallës së parë njëri nga anëtarët nuk mund të merrte pjesë në përbërjen e trupit gjykues;

- trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Tiranë është formuar në kundërshtim me nenin 28/4 të ligjit nr.8456, datë 23.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

4. Është shkelur rregulli i parashikuar në nenin 32/2 të Kushtetuetës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme dhe konkretisht:

- e quajtura L.Cestari është pyetur si dëshmitare në shkelje të nenit 31/d të Kushtetutës, si dhe të nenit 6/3/d të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;

- dëshmia e të quajturit T.Mateus është pranuar si provë në kundërshtim me rregullat

procedurale;

- aktet e dosjes nr.1010/99 të ardhura nga Italia, në bazë të neneve 193, 505 të Kodit të Procedurës Penale dhe neneve 3, 14, 15 të Konventës së Këshillit të Europës "Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale" të datës 20 prill 1957 dhe të protokollit të saj shtesë të datës 17 mars 1997, nuk mund të konsiderohen si prova të vlefshme.

5. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë e ka zhvilluar seancën gjyqësore të datës 18.03.2003 pa praninë e mbrojtësit.

6. Dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk mund të shqyrtojë çështjen në themel, pasi një të drejtë të tillë e ka Kolegji Penal në seancë gjyqësore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorët e çështjes Petrit Plloçi e Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesve, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.356, datë 14.04.2003, ka deklaruar fajtor kërkuesin Arben Bërballa për veprat penale të organizimit dhe drejtimit të organizatave kriminale me qëllim trafikimin e paligjshëm të narkotikëve, parashikuar nga neni 284/a/2 të Kodit Penal si dhe të krijimit të bandës së armatosur dhe organizatës kriminale, parashikuar nga neni 333 i Kodit Penal, dhe në bazë të nenit 55 të Kodit Penal ka caktuar një dënim përfundimtar prej 15 vjet burgim. Po me këtë vendim, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, ka deklaruar fajtor kërkuesin Sokol Koçiu për veprat penale të organizimit dhe drejtimit të organizatave kriminale me qëllim trafikimin e narkotikëve, parashikuar nga neni 284/a/2 i Kodit Penal, të krijimit të bandës së armatosur dhe organizatës kriminale, parashikuar nga neni 333 i Kodit Penal, si dhe falsifikimit të letër njoftimeve apo vizave, parashikuar nga neni 189/1 i Kodit Penal, dhe në bazë të nenit 55 të Kodit Penal i ka caktuar një dënim përfundimtar prej 15 vjet burgim.

Mbi apelimin e kërkuesve Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.599, datë 15.11.2003, lidhur me kërkuesit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.327, datë 28.05.2004, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura edhe nga kërkuesit Arben Bërballa dhe Sokol Koçiu.

Në kërkesat drejtuar Gjykatës Kushtetuese kërkuesit kanë pretenduar se vendimet e mësipërme janë rezultat i një procesi të parregullt ligjor. Parregullsia e procesit sipas kërkuesve, qëndron në shkeljen e parimit të parashikuar nga neni 29 i Kushtetutës, i cili parashikon mosdënimin pa ligj (nullum crimen nulla poena sine lege), të nenit 32/2 që parashikon parimin e mosdënimit mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme të nenit 34 që parashikon mosdënimin më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykimit sërish (ne bis in idem), si dhe të parimeve të tjera, të sanksionuara në nenin 42 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese konstaton se përveç së drejtës për një proces të rregullt ligjor (nenit 42), disa nga të drejtat e tjera kushtetuese individuale që parashikohen në nenet 29, 31, 32, 34 etj. të Kushtetutës shfaqen njëkohësisht edhe si aspekte të rëndësishme të një procesi të rregullt ligjor. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese konfirmon edhe një herë qëndrimin e saj se pretendimet për shkeljen e parimeve themelore që përmbajnë këto të drejta themelore individuale, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, janë objekt shqyrtimi në këtë gjykatë.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimet e parashtruara si në Gjykatën e Lartë, ashtu edhe në këtë Gjykatë janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme. Gjykata e Lartë duhet të investohej në ekzaminimin e tyre dhe të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me to, sepse kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të

zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj.

Përsa më sipër Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimi i atakuar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor dhe si i tillë duhet të deklarohet antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.327, datë 28.05.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.